



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 16646 Prot.

Lezhë, më 02.11. 2023

VENDIM

Nr. 51, Datë 31. 10. 2023

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË, NR.13
DATË 27.07.2023 “ PËR MIRATIMIN E PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË
BASHKISË, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE, TË INSITUCIONEVE TË VARËSISË,
TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE MBËSHTETËSE, TË MASËS SË SHPËRBLIMIT
MUJOR TË KËSHILLTARËVE DHE KRYETARËVE TË FSHATRAVE”**

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” , ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” të ligjit nr.35 datë 25.05.2023 “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës minimale në shkallë vendi”. VKM-së nr.328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksioanrëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.89 datë 22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”, shkresës nr.2344/9 prot., datë 14.06.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.32 datë 30.08.2023 “Për disa shtesa në Vendimin e e Këshillit të Bashkisë nr.120 datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023, shkresës nr.7147/1 prot., datë 10.08.2023 “Kërkesë për përfshirjen në strukturën e bashkisë të punonjësve të projektit të fituar nga shërbimi social”, të Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.1, të VKB-së Nr.13 datë 27.07.2023 “Për miratimin e pagave të administratës së Bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të

punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, shtohet:

75. Pozicioni *“Menaxher i Shërbimeve”*, në projektin *“Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunksionale me bazë komunitare, të fokusuara në fuqizimin, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të familjeve, të rinjve dhe fëmijëve në nevojë”*, (programi buxhetor 10430) , me kategori page III-a/1,
 76. Pozicioni *“Psikolog”*, në projektin *“Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunksionale me bazë komunitare, të fokusuara në fuqizimin, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të familjeve, të rinjve dhe fëmijëve në nevojë”*, (programi buxhetor 10430) , me kategori page IV-a,
 77. Pozicioni *“Punonjës Social për Fëmijë dhe të Rritur”*, në projektin *“Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunksionale me bazë komunitare, të fokusuara në fuqizimin, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të familjeve, të rinjve dhe fëmijëve në nevojë”*, (programi buxhetor 10430), me kategori page IV-a,
 78. Pozicioni *“Punonjës Social për Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave”*, në projektin *“Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunksionale me bazë komunitare, të fokusuara në fuqizimin, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të familjeve, të rinjve dhe fëmijëve në nevojë”*, (programi buxhetor 10430), me kategori page IV-a,
 79. Pozicioni *“Mësues për Shërbimin Edukativ”*, (me kohë të pjesshme) në projektin *“Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunksionale me bazë komunitare, të fokusuara në fuqizimin, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të familjeve, të rinjve dhe fëmijëve në nevojë”*, (programi buxhetor 10430), me kategori page IV-a,
 80. Pozicioni *“Edukatore për shërbimin ditor/parashkollor”*, (me kohë të pjesshme) në Projektin *“Përmirësimi i aksesit në shërbime komunitare dhe zhvillimi i shërbimeve cilësore multifunksionale me bazë komunitare, të fokusuara në fuqizimin, mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të familjeve, të rinjve dhe fëmijëve në nevojë”*, (programi buxhetor 10430), me kategori page IV-a.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULI

